

C.nr. 191/2018

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Mirvete Alidema, me bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani në çështjen kontestimore të paditësit: F.M. nga ..., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.S., jurist i diplomuar nga ..., ndaj të paditurëve: H.1., H.2., S., N., K.M. të gjithë nga fshati ..., K. ..., Sh.M. nga fshati ..., Komuna e ... dhe N.M. nga fshati ..., Komuna e ..., me objekt kontesti- padi për vërtetimin e të drejtës në pronësi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, më dt. 05.10.2018, morri, ndërsa më datë 22 tetor 2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Në bazë të pohimit

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.M., e paraqitur kundër të paditurëve: H.1., H.2., S., N., K.M. të gjithë nga fshati ..., Komuna e ..., Sh.M. nga fshati ..., Komuna e ... dhe N.M. nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të vërtetimit të së drejtës në pronësi dhe.

II. VËRTETOHET se paditësi F.M. nga ..., Komuna e ..., në bazë të shitblerjes është pronar i pronës së paluajtshme në njësinë kadastrale ... me sipërfaqe prej 2030 m², nga sipërfaqja e tërësishme prej 3970 m² e cila sipas ekspertizës do të marr numër të ri të përkohshëm ..., dhe i njësisë kadastrale ... në sipërfaqe prej 2583 m² nga sipërfaqja e tërësishme 9667 m² e cila sipas ekspertizës do të marr numër të ri të përkohshëm ..., të cilat në DGJKP në Gjilan evidentohen në emër të bashkëpronarëve edhe ate: H.1./O./M., H./ O. /M. si dhe R. /O./ M. që të tre nga fshati ..., e të cilat njësi kadastrale.nr. ... kufizohet me sa vijon; nga veriu kufizohet me ngastrën kad.nr. ..., nga lindja kufizohet me ngastrën kad.nr. ..., nga jugu kufizohet me ngastrën kad.nr. ... dhe nga perëndimi kufizohet me ngas.kad.nr. ... ndërsa ngastra kad.nr. ... kufizohet me sa vijon: nga veriu me ngas.kad.nr. ..., nga lindja kufizohet me ngastrën kad.nr. ..., ..., nga jugu kuifizohet me ngastrën kad.nr. ..., ... dhe nga perëndimi kufizohet me ngastrën kad.nr. ... dhe ...

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

1. Jurisdiksioni dhe kompetenca e gjykatës

1.1. Jurisdiksioni i gjykatës është përcaktuar në mbështetje të nenit 11.1 të Ligjit për Gjykatat i Kosovës, ndërsa kompetenca lëndore është përcaktuar në mbështetje të nenit 29 të LPK-së, ndërsa kompetenca territoriale është përcaktuar në mbështetje të neni 41 të LPK-së, si kompetencë territoriale ekskluzive në bazë të vendit ku gjendet paluajtshmëria.

2. Rrjedha e procedurës

2.1. Paditësi, F.M. nga fshati ... Komuna e ..., në këtë gjykatë përmes përfaqësuesit të tij me autorizim F.S. jurist i dip. nga ..., ka paraqitur padi, ndaj të paditurëve: H.1., H.2., S., N., K. M. të gjithë nga fshati ..., Komuna e ..., Sh.M. nga fshati ..., Komuna e ... dhe N.M. nga fshati ..., Komuna e ..., për vërtetimin e të drejtës në pronësi. I njëjti në padi ka theksuar që në vitin 2001, paditësi ka lidhur kontratë verbale me dy të paditurit e parë dhe babain e të paditurve të tjerë, konkretisht me H.1., H.2. dhe R.M. mbi shitblerjen e paluajtshmërive në njësinë kadastrale nr. ..., në vendin e quajtur “ ... ” në sipërfaqe prej 9667 m², si dhe njësia kad.nr. ..., në vendin e quajtur “ ... ” në sipërfaqe prej 3970 m² për çmimin e përgjithshëm në vlerë prej 20,000.00 marka gjermane. Këto parcela në DGJKP në Gjilan evidentohen në emër të paditurit H.1., H.2. dhe F.M. me nga 1/3 e pjesës ideale dhe pasi që i njëjti i kishte paguar çmimin menjëherë kishte hyrë në posedim me mirëbesim të ligjshëm dhe në shfrytëzim të pandërprerë deri më tani.

2.2. Pas pranimit të padisë kjo gjykatë në mbështetje të nenit 394 dhe 395 të LPK-ës palëve të paditura iu ka dërguar një kopje të padisë dhe aktvendimit në mënyrë që të njëjtit të përgjigjen lidhur me pretendimet e tyre.

2.3. Të paditurit H.1., H.2., S., N., Sh., N. dhe K.M., më dt.02.07.2018 kanë paraqitur përgjigje në padi duke e pranuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar në ligj pasi që thëniet në padi janë të sakta ashtu që të njëjtit e pohojnë kërkesëpadinë e paditësit duke i propozuar gjykatës që në bazë të nenit 152 të LPK-ës të nxjerrë aktgjykim pa shqyrtim kryesor të çështjes në bazë të pranimit të kërkesëpadisë.

2.4. Gjykata me qëllim të konstatimit të drejtë të gjenjdes faktike, për këtë çështje ka caktuar seancë përgatitore për dt.27.07.2018 për të cilën seancë kanë qenë të ftuara të gjitha palët ndërgjyqëse në mënyrë të rregullt, por edhe pse ftesat i kanë pranuar në mënyrë të rregullt nuk kanë qenë të pranishëm në seancën dhe mungesën nuk e kanë arsyetuar dhe me propozimin e përfaqësuesit të paditësit seanca e dt.27.07.2018 është mbajtur në mungesë të paditurve.

2.5. Përfaqësuesi i paditësit, F.S. jurist nga Gjilani, si në shqyrtimin përgatitor, kryesor ashtu edhe në fjalë përfundimtare ka deklaruar që në tërësi mbetet si në rregullimin e kërkesëpadisë si dhe deklaratave në seancat gjyqësore dhe pas pranimit të kërkesëpadisë nga të paditurit me anë të përgjigjeve në padi, ka theksuar që janë plotësuar kushtet që gjykata të merr aktgjykim meritore duke ia vërtetuar pronësinë paditësit edhe atë në njësinë kadastrale ... t'i vërtetohen sipërfaqja prej 2583m² që do të marrin numrin e ri të përkohshëm ... si dhe sipërfaqja prej 2577m² që do të marrin numrin e ri ..., e gjithashtu nga njësinë kadastrale ... të vërtetohen sipërfaqja prej 2030m² që do të marrin numër të ri Ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar dhe i ka propozuar gjykatës që të nxjerrë një Aktgjykim në bazë të pohimit duke vërtetuar pronësinë e cekur më lartë.

3.Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

3.1. Në shqyrtimin gjyqësor janë administruar këto prova materiale: Çertifikata e pronës me nr. ..., në emër të H.1., F. dhe R.M. e dt.31.10.2017; Çertifikata e pronës ..., në emër të H.1., F.2. dhe R.M. e dt.31.10.2017; Akt vdekja në emër të R.O. e dt.23.11.2017; dhe Ekspertiza e dt.07.09.2018 e punuar nga eksperti gjeodet I.J. nga Gjilani.

3.2. Gjykata pas analizimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi dhe provat materiale të bashkangjitura padisë si dhe pohimit të kërkesëpadisë nga ana të paditurve ka konstatuar që nga sipërfaqja e njësisë kadastrale nr. ..., tani krijohen numra të rinjë edhe ate: ... dhe ... në sipërfaqe të përgjithshme prej 5160 m2 të cilat evidentohen në emër të tre bashkëpronarëve edhe ate: H.1. /O./ M., H.2./ O./M. si dhe R. /O./ M. që të tre nga fshati B..

3.3. Po ashtu, gjykata konstaton se sipërfaqja e njësisë kadastrale nr. ..., me sipërfaqe prej 3970m², tani merr numër të ri ... dhe është në sipërfaqe prej 2030 m2 e cila evidentohet në emër të tre bashkëpronarëve edhe ate: H.1. /O./ M., H.2./ O. /M. si dhe R. /O./ M. që të tre nga fshati ...

4.Të drejtat disponibile të palëve

4.1. Nga certifikata pronësore me nr. ... të dt.31.10.2017 njësinë kad.nr. ... dhe certifikata pronësore me nr. ... të dt.31.10.2017 njësinë kad.nr. ..., gjykata vërtetoi faktin se të paditurit H.1., H.2. dhe R.M., janë bashkëpronar të këtyre njësive kontestuese ashtu që duke u bazuar në nenin 3 par.2 ku shprehimisht parashihet se “Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtarë si dhe

të bëjnë ujdi (pajtim) gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”, po ashtu gjykata vlerësoi se të paditurit mund të disponojnë lirisht me këtë të drejtë e në këtë rast edhe ta pohojnë kërkesën e paditësit.

5. Dispozitat ligjore të zbatuara me rastin e vendosjes nga gjykata

5.1. Pasi që veprimi juridik është kryer në kohën kur kanë qenë në përdorim markat gjermane, në të cilën kohë njëkohësisht ka qenë në fuqi edhe LTHMJP e vitit 1980, gjykata vendosi si në pikën të I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 33 të Ligjit në fjalë, në të cilën dispozitë materiale është përcaktuar edhe mënyra e fitimit të pronësisë në bazë të veprimit juridik apo punës juridike.

5.2. Meqenëse të paditurit e kanë pohuar kërkesëpadinë e paditësit, atëherë gjykata në mbështetje të nenit 148 paragrafi 1 të LPK-ës vendosi që lidhur me këtë çështje të japin aktgjykim në bazë të pohimit.

5.3. Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 450 të LPK.

5.4. Nga arsyet e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 143 dhe 148 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

G j y q t a r j a,
Mirvete Alidema

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të të njëjtit, vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.